



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

Nr. 8187 Prot.

Fier, më 13.09.2024

NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE

BANORËVE TË KOMUNITETIT TË FIERIT DHE GJITHË PALËVE TË INTERESUARA

Në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, nenit nr.29, “Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike”, nenit nr.18 “Seancat e këshillimeve me bashkësinë” të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në rregulloren e Këshillit Bashkiak për Konsultimet Publike, **Ju** njoftojmë se do të zhvillohet dëgjesa publike në kuadër të,

Hartimit dhe miratimit të dokumenteve të Sigurisë Publike në fushën e Mbrojtjes Civile.

- Miratimi i dokumentit “**Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe Plani i Veprimit**”.

Qëllimi kryesor i Strategjisë Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (Strategjia) është të drejtojë aktivitetet dhe investimet e ardhshme të Bashkisë Fier për menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë në një mënyrë tërësore dhe gjithëpërfshirëse.

Koncepti i Strategjisë Vendore të ZRF-së bazohet në filozofinë kryesore të ZRF-së dhe që është zvogëlimi i riskut të identifikuar, parandalimi i risqeve të reja dhe menaxhimi i riskut të mbetur.

Strategjia vendore për zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe Plani i Veprimit do të jetë dokument bazë Strategjik i Bashkisë Fier që përcakton politikën dhe aktivitetet e institucioneve dhe strukturave vendore, si dhe të gjitha subjekteve të tjera në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë.

Dokumenti duhet të jetë i harmonizuar me Strategjinë Kombëtare për zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe miratohet me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Planifikimi i zhvillimit urban dhe planet e zhvillimit në nivel vendor duhet të bëhen në përputhje me dokumentet e vlerësimit të riskut dhe Strategjisë Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë.

Ftojmë të gjithë grupet e interesit, si: qytetarë, biznese, shoqëri civile, të rinj/të reja të bëhen pjesë e kësaj dëgjese për një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Takimi do të zhvillohet ditën e Enjte, datë 10 Tetor 2024, ora 09.00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.

Ky takim ka si qëllim kryesor bashkëpunimin dhe mbledhjen e rekomandimeve të cilat do të shërbejnë për të siguruar një document sa më cilësor në pronësi të bashkisë Fier në fushën e Mbrojtjes Civile.

Mirëpresim rekomandime, propozime dhe sugjerime konkrete të cilat mund të dërgohen në adresat e mëposhtme të e mail-it:

[Neritan.Bocova@bashkiafier.gov.al](mailto: Neritan.Bocova@bashkiafier.gov.al) , Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

[nasipbani67@gmail.com.al](mailto: nasipbani67@gmail.com.al) , Drejtor i Mbrojtjes Civile, Bashkia Fier.

Dëgjesa do të zhvillohet në bashkëpunim me bashkinë dhe anëtarë/ përfaqësues të Këshillit Bashkiak, Fier.

Jeni të lutur të merrni pjesë pasi pjesëmarrja Juaj është shumë e rëndësishme.

Ju faleminderit!

KRYETARI I BASHKISË
Armando SUBASHI

NË MUNGESË DHE ME URDIHËR
ZËVENDËS KRYETAR
Andius OLLDASHI

